



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 595/25 Datë: 27.05.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 137 të mbajtur më 19.05.2025, mori:

V E N D I M

- I.** Riakreditohet në nivel Institucional Akademia Evolucion për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
- II.** Riakreditohet programet i studimeve Akademia Evolucion për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2030):
 - Dizajn i Modës, 180 ECTS (BA), me kuotë 60 studente për vit akademik.
 - Dizajn i Modës, 120 ECTS (MA); me kuotë 60 studente për vit akademik.
 - Dizajn i Komunikimit, 180 ECTS (BA); me kuotë 60 studente për vit akademik.
- III.** Akreditohet programi i studimeve Akademia Evolucion për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 - Stilizëm dhe Komunikim në Modë, 180 ECTS, (BA); me kuotë 60 studente për vit akademik.
- IV.** Numri i studentëve vlen dhe zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- V.** Obligohet Akademia Evolucion, që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.

VI. Obligohet Akademia Evolucion, të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.

VII. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Akademia Evolucion brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditim institucional dhe ri/akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1.	Dizajn i Modës, 180 ECTS (BA), R	Besim Hoxha. Dorina Gashi. Elmedina Rrahmani. Ylber Rrukiqi. Vlora Qorri Mustafa. Mirlinda Rexhepi Osaj. Shpetim Bunjaku.
2.	Dizajn i Modës, 120 ECTS (MA), R	Flora Loshi. Vesa Govori Hapciu. Florina Hoxha. Fjolla Qela.
3.	Dizajn i Komunikimit, 180 ECTS (BA), R	Arta Agani. Arsim Shala. Granit Dragaj. Shpat Komoni.
4.	Stilizëm dhe Komunikim në Modë, 180 ECTS (BA), A	Eljesa Salla. Labentine Shala. Drilon Kurteshi. Donika Makolli. Arlinda Zylali.

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Akademia Evolucion.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për vlerësimin për riakreditim institucional vizita me ekspert ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 11.03.2025 me këtë përbërje: Milan Pol, Olgun Cicek dhe Domagoj Svirig. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se Akademia Evolucion për riakreditim instituciona është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht përmbush katër (4) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.

1. **Për programin e studimit; Dizajn i Modës, 180 ECTS (BA)**, vizita me ekspert ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 23.04.2025 me këtë përbërje: Costas Mantzalos, John Butler dhe Alicia Presencio Herreo. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht të shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit.
2. **Për programin e studimit; Dizajn i Modës, 120 ECTS (MA)**, vizita me ekspert ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 23.04.2025 me këtë përbërje: Costas Mantzalos, John Butler dhe Alicia Presencio Herreo. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht të shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit.
3. **Për programin e studimit; Dizajn i Komunikimit, 180 ECTS (BA)**, vizita me ekspert ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 24.04.2025 me këtë përbërje: Tauno Otto, Ioannis Sarris dhe Arnoldas Solovjovas. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht të shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit.
4. **Për programin e studimit; Stilizëm dhe Komunikim në Modë, 180 ECTS (BA)**, vizita me ekspert ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 24.04.2025 me këtë përbërje: Tauno Otto, Ioannis Sarris dhe Arnoldas Solovjovas. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht të shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 137-të, të mbajtur më datë 19.05.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Akademia Evolucion dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Hazi

Vendimi iu dërgohet:

- Akademia Evolucion;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë